



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 05/ Prot.

33

ex 21

Tiranë, më 28.01.2022

V E N D I M

Nr. 04, datë 28.01.2022

Për disa ndryshime në Rregulloren nr.21/6prot, datë 10.06.2020, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve të Prokurorisë”.

Komisioni i Policisë Gjyqësore, i mbledhur sot në datën 28.01.2022, nenin 11, pika 6 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, pasi mori në shqyrtim propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, nr.1284/177 ex-21 prot., datë 26.01.2022, “Për disa ndryshime në Rregulloren nr.21/6, datë 10.06.2020, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve të Prokurorisë” dhe analizoi çështjen në tërësi,

V E N D O S I :

Në rregulloren nr.21/6, datë 10.06.2020, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, “Për caktimin e rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve të Prokurorisë”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 e nenit 5 të rregullores ndryshohet duke u formuluar:  
“Prokurori i Përgjithshëm, për zhvillimin e konkurimit ngre një komision të përbërë nga tre anëtar. Komisioni përbëhet nga prokurorë ose nga prokuror dhe oficerë të Policisë Gjyqësore me eksperiencë”.
2. Në nenin 6, pika 8, shkronja b), ndryshohet si më poshtë:  
“Për fazën e dytë, në të cilën kryet testimi profesional nëpërmjet zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët mund të marrin deri në 50 pikë. Testimi profesional me shkrim ndërtohet mbi bazën e testimit me përgjigje alternative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi i dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm dhe botohet ne faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, në hapësirën e lënë për Komisionin e Policisë Gjyqësore.

K O M I S I O N I  
K R Y E T A R I  
Alfred PROGONATI

ANËTAR  
Arjan MUÇA

ANËTAR  
Hari GOGO  
mungon



ANËTAR  
Odise MOÇKA  
mungon

ANËTAR  
Albert MUÇO